



### VENDIM

*Nr. 121 Datë 28.10.2013*

### MBI

#### **FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LIÇENSËS ME NR. 17, SERIA PV04P, TË SHOQËRISË “MARJAKAJ” SH.P.K, PËR “PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE” NGA HEC “BENE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR 43, DATË 14.10.2004**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9; 13 pika 1, gërma “a”; 19 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 10, pika 3; 15 pika 1, pika 2 gërma “b”, pika 4 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008; pikave 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike”; nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Marjakaj” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

#### **Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”** : Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës.

Meqënëse në kërkesën e subjektit aplikues për modifikim, saktësimi i parametrave teknik të skemës së shfrytëzimit energjistik të ujrave të përroit të Benes nuk është dhënë i qartë, do të kërkohet nga ky subjekt, që brenda afatit dy mujor të zbatimit të procedurave të ERE, të paraqitet në ERE një informacion teknik lidhur saktësimin e këtyre parametrave.

- ***Neni 15, pika 4, gërma “b”:*** Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim license.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e liçensës me nr. 17, seria PV04P, të shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bene”, me fuqi 125 KW të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 43 datë 14.10.2004.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**